



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:005741

Datë: 16.07.2024

Numri i dokumentit: 05943144

**C-IV-14-1899**

*Ankuesi:*

**H Xh- K. Mitrovicë**

**Kundër**

*Pala kundërshtare:*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Dr. Sc. Murat Hulaj, me dt.16 korrik 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e ankueses H Xh dhe **VËRTETOHET**, vendimi i Autoritetit të Likuidimitnr.MIT039-610 te dt. 19.shkurt 2014
- Secila palë i bartë shpenzimet e veta gjyqësore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.21 mars 2014, ankuesja parashtroj padi-ankesë, kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit: Vendimit nr.MIT039-610 te dt. 19.02.2014, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa si e pavlefshme për kompensimin e 3(tri) paga të pa paguara në shumë prej 180.00€, sipas Vendimit te paditurës –AL për NSH “Lux” (në likuidim). Me teje shton se vendimi i marrë është i përfshirë me *shkelje te prezumimeve procedurale, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar të së drejtës materiale*. Ne vendimin qe më është refuzuara kërkesa potencohet se kërkesa ime është parashkruar. Me teje ankuesi deklaroi se ka qenë punëtor aktiv në këtë ndërmarrje gjerë në momentin e privatizimit të shtëpisë së mallrave pra pronës se parë që është privatizuar nga Agjencia në muajin mars të vitit 2004, duke qenë në listën e pagave në tri vitet e fundit para privatizimit dhe duke përfituar nga shpërndarja e 20% në përputhje me rregulloren që rregullon këtë të drejtë . Për këtë Autoriteti e ka konstatuar gabimisht gjendjen faktike duke pretenduar se unë nuk kam punuar ne momentin ne privatizimit.

Gjithashtu thekson se e paditura nuk e ka marrë për bazë se e drejta e punëtorëve të ndikuar nga privatizimi do të realizohet pas likuidimit të ndërmarrjes nga Agjencia , pra Agjencia ka pasur kontratë obligues që t’i kompensoj tri pagat e pa paguara ose kompensimin nga ndërprerja e

marrëdhënies se punës vetëm pas hyrjes ne likuidim te ndërmarrjes. Duke u mbështetur ne faktet e lartpërmendura dhe provat e bashkangjitura :

- Dëshminë e dorëzimit të kërkesës brenda afatit
- Listën e punëtorëve
- Listën e publikuar dhe
- Arsyetimin për vonës,

DHPGJS i ka propozua qe ta Aprovoj ankesën kundër vendimit te AL , dhe të ja pranoj shumen e burgjitë prej 180 euro si kreditor, krahas ka kërkuar qe e paditura paguarjen e shpenzimeve për përkthim dhe ato te tarifave gjyqësor.

Së bashku me ankesën ai ka bashkëngjitur kopjen e vendimit të kundërshtuar.

Me dt.04.04.2024, e paditura AKP ne DHPGJS ka deponua përgjigjen-mbrojtjen në raport me ankesën/padinë e paditëses, përmes të secilës ka pohuar se vendimi i AL nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe se AL, ka bërë një vlerësim të saktë, të rrethanave faktike, dhe se dispozitat ligjore në fuqi janë zbatuar drejtë. Konsideron, se objekt i kësaj procedure, është vetëm ligjshmëria e vendimit të kundërshtuar. Parashtruesi nuk ka treguar se cilin nen e ka shkelur AL me vendimin e saj dhe nuk ka ofruar asnjë argument ligjor. Ka kërkuar që në bazë të dispozitave ligjore, gjykata ta refuzoj ankesën e ankueses.

Me dt.29 prill 2024, gjykata ka kërkuar nga ankuesi që të bëjë dorëzimin e provave shtesë dhe atë: kopjen e librezës së punës, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe listën e pagave si dhe prova tjera që dëshmojnë pretendime ankimore. I njëjta nuk i është përgjigjur urdhrin te dt. 29 prill 2024, edhe pse sipas flete kthesës rezulton se e ka pranua urdhrin e gjykatës përmes të secilit i janë kërkuar provat e sipër cekura në urdhër.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Ankuesja ka dorëzuar vetëm vendimin e Autoritetit të Likuidimit e jo ndonjë provë tjetër, edhe pse sipas Urdhrit të fundit të datës 29 prill 2024 e me qëllim të sqarimit të pretendimeve të sajë i janë kërkuar provat e cekura me lartë në urdhër, mirëpo e njëjta edhe pse ka qenë e njoftuar me urdhrin dhe provat kërkuar nga gjykata Ankuesja ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së saj edhe pas parashtrimit të ankesës në DHPGJS.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesja e ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, siç janë dokumentet me anë të së cilave do të dëshmonte se sa ka punuar te NSH, kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës si dhe cila ka qenë paga të cilën ankuesi e ka pranuar, vendimin kur ka fillua dhe deri kur ka punuar dhe kur ju ka ndërpre puna, librezën e punës me të cilën dëshmohet fillimi dhe mbyllja eventuale e mardhenjës së punës. Ankuesja nuk e ka bërë as dorëzimin e vendimit të atakuar, por gjykata u lëshua në merita të kësaj lënde për faktin se të njëjtin e kishe sjellë pala e paditur. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Ankuesi e ka bërë dorëzimin e faqes së parë të librezës së punës e cila nuk dëshmon të drejtën e pretenduar, andaj dhe pretendimet e tij nuk i është bazuara.

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore për padi me dt.27 mars 2024.

### **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Dr.sc. Murat Hulaj, Gjyqtar

---